



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 3487/1 Prot

Rrëshen më, 30 . 09 . 2024

V E N D I M

Nr. 76 datë 25. 09. 2024

P Ë R

“NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 53, DATË 03. 06. 2024, “PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË DHURIMIT NDËRMJET; SHOQËRISË KONÇESIONARE “SEKA HYDROPOWER” SHPK DHE BASHKISË MIRDITË, PËRFAQËSUAR NGA KRYETARI Z. ALBERT MËLYSHI”.

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", në Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin Plotësues nr. 1, datë 24.01.2024 të ministrisë Ekonomisë dhe Financave, "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2024", në Vendimin nr. 50, datë 15.12.2023, të këshillit bashkiak Mirditë, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024", VKB nr. 53, datë 03.06.2024, "Për miratimin e Kontratës Dhurimit ndërmjet: Shoqërisë Konçesionare "Seka Hydropower" shpk dhe bashkisë Mirditë, përfaqësuar nga Kryetari Z. Albert MËLYSHI, me objekt: "Mirëmbajtjen e rrugëve rurale me fuqi punëtore", projekt-vendimin e paraqitur nga kryetari i bashkisë, *shqyrtimit në mbledhjen e datës 23.09.2024, të Komisionit Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit*, për t'ia kaluar në seancë këshillit bashkiak, pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimet VKB nr. 53, datë 03.06.2024, "Për miratimin e Kontratës Dhurimit ndërmjet: Shoqërisë Konçesionare "Seka Hydropower" Shpk dhe bashkisë Mirditë, përfaqësuar nga Kryetari Z. Albert MËLYSHI, si më poshtë vijon;
2. Në pikën 1 (një), të shtohet paragrafi: "2 (dy) punonjës mirëmbajtje të cilët do kontraktohen sipas legjislacionit në fuqi nga agjencia e punëve publike dhe mirëmbajtjes – APPM, për periudhën e financimit nga donatori"

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233


www.bashkiamirdite.gov.al

3. Në pikën 2 (dy), të shtohet paragrafi; "shuma e dhurimit prej 1 200 000 lekë, do të përdoret për financimin e pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për punonjësit e kontartuar sipas pikës 1 (një)".
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i bashkisë Mirditë, (drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe agjencia e punëve publike dhe mirëmbajtjes - APPM).

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICAËU





BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË

Nr. 3487 Prot

Datë 16.09 /2024

P/V E N D I M

Nr. 85 date 16.09.2024

“PËR NJE NDRYSHIM NE VKB NR.53, DATE.03.06.2024 “PER MIRATIMIN E KONTRATËS SË DHURIMIT NDËRMJET SHOQERISE KONÇENSIONARE “SEKA HYDROPOWER” SHPK DHE BASHKISË MIRDITË”

Mbështetur në ligjit 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ne ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligji nr.45/2019 “Per mbrojtjen civile”, në ligjit nr.97/2023, “Per buxhetin e vitit 2024”, “Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, udhëzimit plotesues të MFE nr.1, datë.24.01.2024 “Per zbatimin e buxhetit te vitit 2024”, VKB nr.50 datë 15.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024”, ne vkb nr.53, date.03.06.2024 “per miratimin e kontratës së dhurimit ndërmjet shoqerise konçensionare “seka hydropower” shpk dhe bashkisë Mirditë”, këshilli i Bashkisë Mirditë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i Bashkise;

V E N D O S I:

-Te beje ndryshimet ne vkb nr.53, date.03.06.2024 “per miratimin e kontratës së dhurimit ndërmjet shoqerise konçensionare “seka hydropower” shpk dhe bashkisë Mirditë” si me poshte:

1. Ne piken 1(nje) te projekt vendimit nr 53, date.03.06.2024 te shtoje paragrafin “Te shtohen 2(dy) punonjes mirmbajtje, te cilet do kontraktohen sipas legjislacionit ne fuqi nga APPM, per periudhen e financimit nga Donatori”.
2. Ne piken 2(dy) te projekt vendimit nr 53, date.03.06.2024 te shtoje paragrafin “shuma e dhurimit prej 1 200 000(njemiljonedeqinmije) leke, do te perdoret, per financimin e pagave , sigurimeve shoqerore dhe shendetsore , per punonjesit e kontraktuar sipas pikes 1(nje).
- 3.. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise .
- 4.. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

KRYETARI

Gaspër TOPOLLAJ

Aleksander PICAKU

Paraqiten projektin

Dr.Juridike, prok, protokoll: B. Deda

Dr./zhvill ek dhe tatim taksat: V.Gjoka

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov

KRYETARI
Albert MEËYSHI

